



Implemented by  
**giz** Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



European Union Network for the  
Implementation and Enforcement  
of Environmental Law

# SPIDER WEB

Strategic Project to Increase the Detection and Disruption  
of Environmental Crime in the Western Balkans

## Raport i projektit



Dhjetor 2019

# **Lufta kundër krimeve të rënda në Ballkanin Perëndimor: Raport i projektit për krimin mjedisor dhe në sektorin e mbetjeve, në Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë<sup>1\*</sup>, Republikën e Maqedonisë së Veriut, Mal të Zi dhe Serbi**

---

<sup>1\*</sup> Ky emërtim është pa paragjykime të qëndrimeve mbi statusin dhe në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244/1999 dhe Opinionin ICJ mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

## Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje ekzekutive .....	4
Falënderime.....	6
1. Hyrje.....	7
2. Fushëveprimi dhe fokusi .....	7
3. Metodologjia.....	8
4. Përmbajtja e trajnimeve .....	9
5. Trajnimet dhe pjesëmarrja .....	9
6. Vlerësimi.....	10
7. Paketë trajnimi online .....	11
8. Konferenca përfundimtare e projektit SPIDERWEB .....	11
9. Përfundime dhe rekomandime .....	11
9.1. Përfundime.....	11
9.2. Rekomandime .....	12
9.2.1. Të përgjithshme.....	12
9.2.2. Niveli kombëtar.....	13
9.2.3. Bashkëpunimi ndërkufitar .....	14

## Përmbledhje ekzekutive

Gjatë periudhës 2018 –2019, me financim nga Deutsche Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ), u realizua një projekt nga Rrjeti i Bashkimit Evropian për Zbatimin dhe Aplikimin e Ligjit Mjedisor (IMPEL), me synim ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e trajtimit të krimeve mjedisore dhe kapacitetet e të gjithë aktorëve në zinxhirin e autoriteteve të përputhshmërisë dhe aplikimit në gjashtë ekonomi të Ballkanit Perëndimor, për t'iu dhënë fund dhe për të ndjekur penalisht krimet mjedisore.

### Studimi bazë

Hapi i parë i projektit ishte një studim bazë për të kuptuar situatën aktuale dhe mangësitë e mundshme në zbatimin dhe aplikimin praktik të legjislacionit për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mbetjet. Rezultatet e studimit ofruan një tablo të përgjithshme të nivelit të legjislacionit mjedisor përkatës. Si rrjedhojë, mungesat në zbatimin dhe aplikimin e legjislacionit ekzistues për mbetjet dhe krimet në natyrë duket se janë sfida kryesore në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Krahas kësaj, janë theksuar edhe disa elemente të tjera, si: mungesa e ndërgjegjësimit mbi krimin mjedisor në përgjithësi, dhe krimet e lidhura me botën e egër dhe mbetjet në veçanti, si dhe dhënia e pakët e përparësisë për këto krime nga ana e institucioneve qeveritare, agjencitë ligjzbatuese, prokuroria dhe pushteti gjyqësor.

### Vlerësimi i nevojave për trajnim

Hapi i radhës ishte vlerësimi i nevojave për trajnim. Nga ky studim u konstatua se, ndonëse të gjithë përfituesit kanë qenë pjesë e nismave mbi problematikat e krimit mjedisor, nevojitet edhe trajnime të mëtejshme për të gjithë aktorët në zinxhirin e autoriteteve të përputhshmërisë dhe zbatimit. Krahas trajnimit mbi ndërgjegjësimin e të gjitha palëve të interesit, trajnimet duhet të jenë praktike, të fokusuara dhe të përshtaten sipas nevojave të grupeve të synuara.

### Aktivite trajnuese kombëtare

Gjatë periudhës maj – nëntor 2019 janë ofruar gjashtë trajnime kombëtare, ku kanë marrë pjesë inspektorë të mjedisit, oficerë policie, doganierë, prokurorë publikë, gjykatës, politikëbërës, lejedhënës, avokatë populli dhe OJF. Gjithsej u trajnuan 162 zyrtarë, duke ruajtur një ekuilibër midis palëve kyçe të interesit që janë pjesë e zinxhirit të autoriteteve të Përputhshmërisë dhe Zbatimit.

Ndonëse përqendrohej përgjithësisht te problemet mjedisore, projekti i dha përparësi kuptimit të shkaqeve bazë dhe mënyrës se si kryheshin krimet mjedisore, dhe se si t'i jepej fund dhe të ndiqeshin penalisht krimet mjedisore në fushën e Mbrojtjes së Natyrës dhe Menaxhimit të Mbetjeve. Sipas rastit, pjesë e projektit ishin edhe ligje të tjera përkatëse, si: Direktiva për Detyrime dhe Direktiva për Krimin Mjedisor. Gjatë trajnimit, vëmendje e veçantë iu kushtua rëndësisë së koordinimit, bashkëpunimit dhe partneritetit midis të gjitha palëve të interesit të përfshira në zinxhirin e autoriteteve të përputhshmërisë dhe zbatimit. Krahas ofrimit dhe diskutimit të teorisë, u fol edhe për qasjet e mbledhjes së provave, ndarjen dhe analizimin e informacionit, bashkëpunimin ndërkufitar dhe përfshirjen e ekspertizës specifike.

Trajnimet u mirëpritën dhe u vlerësuan shumë nga pjesëmarrësit, të cilët pohuan se arrinin ta kuptonin më mirë rëndësinë e trajtimit të krimeve mjedisore dhe ndikimin e tyre (negativ) në shëndetin e njeriut, mjedisin dhe ekonominë. Veç këtyre, pjesëmarrësit pranuan edhe nevojën për bashkëpunimin dhe partneritetin shumëdisiplinor midis aktorëve kyç në zinxhirin e autoriteteve të përputhshmërisë dhe zbatimit. Ata përmendën se përmirësimi dhe formalizimi i bashkëpunimit në nivel kombëtar do të rrisë efektshmërinë e luftës ndaj krimit mjedisor. Krahas kësaj, u propozua që t'i jepej përparësi bashkëpunimit

me organizatat e specializuara dhe/ose specializimit të autoriteteve. Gjithashtu, ekonomitë e Ballkanit Perëndimor rekomanduan ngritjen e një rrjeti rajonal autoritetesh, të përfshira në trajtimin e krimit mjedisor, ose shkëmbimin e përvojës dhe praktikave të mira, ose në koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta nëpërmjet mbledhjeve të rregullta.

### Instrument për trajnimet online

Materialet e përdorura gjatë trajnimit, si: prezantime, raste studimore dhe referenca të legjislacionit dhe instrumenteve u mbledhën dhe u hodhën në një platformë online: Portali për Zbatuesit Mjedisorë<sup>2</sup> (PREVENT). Gjithashtu u zhvilluan dy paketa instrumentesh, njëra për Krimin Mjedisor dhe tjetra për Krimin në Sektorin e Mbetjeve. Qëllimi i këtyre paketave ishte që t'iu ofronin agjencive ligjzbatuese, autoriteteve doganore dhe portuale, inspektorëve të mjedisit, prokurorëve dhe gjykatësve, informacione thelbësore për botën e egër dhe krimet në sektorin e mbetjeve, mbetjet ndërkombëtare, si dhe traktatet dhe rregulloret për botën e egër. Paketat e Instrumenteve përmbajnë informacione dhe praktika të mira nga manualet dhe raportet përkatëse, legjislacioni, rastet studimore, si dhe instrumentet e mbledhura dhe të posaçme për mbështetjen e të gjithë zinxhirit të aplikimit në luftën me kosto efektive kundër krimit ndërkufitar ndaj botës së egër.

### Konferenca përmbyllëse

Më 13 nëntor 2019 u mbajt konferenca përmbyllëse e SPIDER WEB-it, e cila doli me rekomandimet e mëposhtme:

- Organizatat që promovojnë forcimin e luftës ndaj krimit mjedisor në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor duhet të vazhdojnë ta mbështesin rajonin duke organizuar dhe financuar aktivitete praktike, si: ngritja e kapaciteteve dhe projektet e përbashkëta. Si kompensim, organizatat e ekonomive të Ballkanit Perëndimor duhet të ofrojnë burimet e nevojshme të ekspertizës për t'i menaxhuar dhe për t'i drejtuar këto aktivitete në kohë.
- Duke u mbështetur te përvoja e projektit SPIDER WEB, duhet marrë parasysh dhe nxitur vazhdimësia duke u përqendruar te trajnimet praktike dhe të specializuara, me synim përmirësimin e identifikimit të rasteve të krimit mjedisor. Kjo mund të realizohet ose horizontalisht (duke përfshirë të gjithë aktorët në zinxhirin e autoriteteve të përputhshmërisë dhe zbatimit) dhe/ose vertikalisht (duke u përqendruar te një autoritet specifik, si: dogana, pushteti gjyqësor ose inspektorati i mjedisit).
- Lidhja e partneritetit me sektorin privat, si dhe bashkëpunimi dhe shkëmbimi i rregullt i informacionit me OJF-të kombëtare, që veprojnë në fushën e mjedisit, dhe diskutimi i masave të përshtatshme për të përmirësuar rolin e këtyre të fundit në ndjekjet penale.
- Hartimi i programeve të parandalimit dhe zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese kundër krimit mjedisor, me synim sektorin publik dhe/ose grupe specifike në rrezik, sjellje të rrezikshme, si dhe subjekte mjedisore me rrezik të lartë.

---

<sup>2</sup>PREVENT gjendet në: [www.impel-prevent.eu](http://www.impel-prevent.eu)

## Falënderime

Ky raport, i autorizuar nga IMPEL, u përgatit nga pjesëtarët e ekipit të SPIDERWEB-it, të cilët janë ekspertë nga Holanda, Skocia, Portugalia, Turqia dhe Zvicra.

Ekipi i SPIDERWEB-it dëshiron të shprehë vlerësimin ndaj të gjithë ekspertëve, gjykatësve, prokurorëve, inspektorëve të mjedisit, oficerëve të policisë, doganierëve dhe institucioneve në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, Republikën e Maqedonisë së Veriut, Kosovën\*, Malin e Zi dhe Serbinë, që morën pjesë në trajnime dhe ndanë njohuritë dhe përvojën e tyre. Krahas kësaj, falënderojmë Grupin e Konsultimit, që përfshinte përfaqësues nga të gjashtë Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, Gjykatën Penale Segovia, si dhe Sekretariatit e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC).

Një falënderim i veçantë shkon për Koordinatorët Kombëtarë të IMPEL-it për kontributin e tyre të jashtëzakonshëm ndaj organizimit dhe realizimit të trajnimit në ekonomitë e tyre. Kontributi i tyre ndaj projektit SPIDERWEB është shumë i vyer. Krahas kësaj, falënderojmë edhe ekspertët kombëtarë nga Holanda, Finlanda, Gjermania, Kroacia dhe Serbia për mbështetjen e tyre teknike gjatë aktiviteteve të trajnimit.

Ekipi i SPIDERWEB-it dëshiron të falënderojë Bashkëpunimin Gjerman – Deutsche Zusammenarbeit, zbatuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), për mbështetjen financiare dhe bashkëpunimin.

### **Ekipi i projektit SPIDER WEB:**

*Nancy Isarin (Menaxhere projekti)*

*Chris Dijkens (Moderator dhe raportues)*

*Jaap Reijngoud (Ekspert i botës së egër)*

*Fraser Allan (Ekspert i mbetjeve)*

*Ellen Greve (Përgjegjëse për Komunikimin)*

*Pinar Topkaya (Përgjegjëse mbështetëse në administrim)*

---

\*Ky emërtim është pa paragjykim të qëndrimeve mbi statusin dhe në përputhje me UNSCR 1244/1999 dhe Opinionin ICJ mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.



## 1. Hyrje

Krimi mjedisor është një krim i rëndë kombëtar dhe ndërkombëtar, duke ndikuar ndjeshëm negativisht mbi shëndetin e njeriut, ekosisteme, mjedis dhe ekonomi. Krahas kësaj, krimet mjedisore dëmtojnë politikat e qeverisë për menaxhimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit, si dhe sabotojnë shtetin e së drejtës.

Lufta ndaj krimit të rëndë dhe të organizuar, duke përfshirë shkeljet mjedisore të rregulluara nga marrëveshjet dhe legjislacioni ndërkombëtar dhe i BE-së, si: vrasja, shkatërrimi, zotërimi ose tregtimi i ekzemplarëve të faunës së mbrojtur (veçanërisht shpendët) ose speciet bimore, rregullorja për prerjen e paligjshme të pemëve/druve, ose mbledhja, transporti, rikuperimi ose depozitimi i papërshtatshëm i mbetjeve (të rrezikshme), janë disa prej sfidave kyçe në Evropë. Ndërgjegjësimi mjedisor i pakët, mbledhje dhe shkëmbimi jociësor i informacionit, burimet njerëzore dhe financiare të pamjaftueshme, si dhe bashkëpunimi i dobët midis palëve kyçe të informacionit pengojnë qasjet efikase dhe të përshtatshme në luftën kundër krimit mjedisor. Sot, shkeljet e legjislacionit mjedisor ende nuk konsiderohen parësore, por ndikimi i tyre negativ mbetet i ndjeshëm.

Gjatë periudhës 2018 – 2019, me financim nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), u realizua një projekt nga Rrjeti i Bashkimit Evropian për Aplikimin dhe Zbatimin e Ligjit Mjedisor (IMPEL), me synim ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e trajtimit të krimeve mjedisore dhe kapacitetet e të gjithë aktorëve në zinxhirin e autoriteteve të përputhshmërisë dhe zbatimit në gjashtë ekonomi të Ballkanit Perëndimor, për t'iu dhënë fund dhe për të ndjekur penalisht krimet mjedisore.

## 2. Fushëveprimi dhe fokusi

Shpërndarja gjeografike e projektit përfshinte gjashtë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor:

- Shqipëri
- Bosnjë-Hercegovinë
- Republika e Maqedonisë së Veriut
- Kosovë\*
- Mal i Zi
- Serbi



Ndonëse përqendrohej përgjithësisht te problemet mjedisore, projekti i dha përparësi kuptimit të shkaqeve bazë të krimit mjedisor, dhe se si t'i jepej fund dhe të ndiqeshin penalisht krimet mjedisore në fushën e:

1. Mbrojtjes së Natyrës; duke përfshirë Rregulloren e BE-së për Tregtinë e Botës së Egër, Direktivën për Shpendët dhe Habitatet, si dhe rregullore të tjera në lidhje me Mbrojtjen e Natyrës, si: Rregullorja e BE-së për lëndët drusore (EU TR), dhe Rregullore për Speciet Aliene Invazive (IAS).

---


\*Ky emërtim është pa paragjyqime të qëndrimeve mbi statusin dhe në përputhje me UNSCR 1244/1999 dhe Opinionin ICJ mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

2. Menaxhimit të Mbetjeve; ku mbuloheshin të gjitha aspektet e zinxhirit të autoriteteve, nga pika e gjenerimit të transporti dhe trajtimi, që parashikohen në Direktivat dhe Rregulloret e BE-së për Mbetjet (duke përfshirë Direktivën Kuadër të Mbetjeve, Listën Evropiane të Mbetjeve, Rregulloren për Transportin e Mbetjeve, si dhe ligje të posaçme për mbetjet).

Sipas nevojës, pjesë e projektit ishin edhe ligje të tjera përkatëse, si: Direktiva për Detyrime dhe Direktiva për Krimin Mjedisor. Vëmendje e veçantë iu kushtua rëndësisë së koordinimit, bashkëpunimit dhe partneritetit midis të gjitha palëve të interesit të përfshira në zinxhirin e autoriteteve të përputhshmërisë dhe zbatimit, çka është kyçe për efektshmërinë dhe efikasitetin e një sërë krimesh mjedisore.

### 3. Metodologjia

Metodologjia e projektit u krye në tre faza: Studimi Bazë, Trajnimi dhe Zbatimi. Për secilën fazë u kryen këto aktivitete:



**Faza e parë (baza fillestare)** përfshinte aplikimin e studimit bazë në gjashtë ekonomi të Ballkanit Perëndimor mbi situatën aktuale dhe mangësitë e mundshme në zbatimin dhe aplikimin praktik të legjislacionit mjedisor dhe në veçanti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Menaxhimin e Mbetjeve. U krye shqyrtimi i dokumentacionit nëpërmjet një analize të hollësishme mbi kuadrin ligjor të Ekonomive të Ballkanit Perëndimor, si dhe raporte që mbulonin nivelin e aplikimit. Burimet kryesore për këtë detyrë ishin progres raportet e BE-së, dokumentet e UNECE-s, UNEP si dhe dokumente të tjera zyrtare. Krahas kësaj, u mbajtën 49 intervista me përfaqësues të autoriteteve. Rezultatet e studimit bazë ofruan një panoramë gjithëpërfshirëse dhe të hollësishme të nivelit të aplikimit të legjislacionit mjedisor përkatës, sfidat e njohura për të ardhmen, si dhe një vështrim i parë i nevojave për trajnim në fushën e trajtimit të krimit mjedisor. Mungesat në zbatimin dhe aplikimin e legjislacionit ekzistues për mbetjet dhe krimet në natyrë duket se janë sfida kryesore në rajon. Gjithashtu, është vënë në pah edhe mungesa e ndërgjegjësimit mbi krimin mjedisor në përgjithësi, dhe krimet e lidhura me botën e egër dhe mbetjet në veçanti, si dhe dhënia e pakët e përparësisë për këto krime nga ana e institucioneve qeveritare, agjencitë ligjzbatuese, prokuroria dhe pushteti gjyqësor.

Hapi i radhës ishte 'vlerësimi i nevojave për trajnim' i kryer midis autoriteteve të përfshira, i cili u përqendrua mbi njohuritë aktuale dhe kapacitetet e nevojës për trajnim të palëve të interesit përgjatë zinxhirit të autoriteteve të përputhshmërisë dhe zbatimit. Ndër të tjera, iu drejtua një pyetësor online palëve të identifikuara të interesit. Duke u bazuar mbi rezultatin e vlerësimit, u zhvilluan kurrikula të përshtatura trajnimi. Studimi konstatoi se ka nevojë për më shumë trajnim, duke u përqendruar në ndërgjegjësimin e të gjitha palëve të interesit. Trajnimet duhet të jenë praktike, të fokusuar dhe të përshtatura sipas nevojave të grupeve të synuara.



Në fazën e dytë (Trajnimi) të projektit, u zhvilluan materiale trajnimi, si dhe u realizuan trajnime në ekonomitë e përfshira të Ballkanit Perëndimor. Trajnimet përfshinin prezantime, përdorimin e instrumenteve, ushtrime, seanca specifike, raste studimore dhe orientim për përdorim nga grupet e ndryshme pjesëmarrëse (lejdhënës, inspektorë, oficerë policie, prokurorë dhe gjyqtarë) në workshop-et e trajnimit. Një pjesë e trajnimit iu dedikua rritjes së ndërgjegjësimit të përgjithshëm mbi trajtimin e krimit mjedisor, dhe mbi aspektet e koordinimit, bashkëpunimit dhe partneriteti ndërmjet të gjithë palëve të interesit përgjatë zinxhirit të autoriteteve të përputhshmërisë dhe zbatimit. Gjithashtu, aktivitetet e trajnimit kontribuuan në shpërndarjen e instrumenteve ekzistuese dhe të reja të zhvilluara nga IMPEL (si: Udhëzuesi për Planin e Inspektimit të Efektshëm të Dorëzimit të Mbetjeve dhe Udhëzuesi për mbrojtjen e natyrës në lejimin dhe inspektimin e instalimeve industriale ) dhe zgjerimin e sinergjisë dhe bashkëpunimit.

**Faza e tretë** e projektit (Zbatimi) u përqendrua në projektimin dhe zhvillimin e instrumentit dhe manualit të trajnimit online, në organizimin e konferencës përmbyllëse të SPIDERWEB-it dhe në hartimin e raportit të projektit.

Instrumenti i trajnimit përmbledh fushat kyçe të të nxënit nga kurset e trajnimit dhe përmban seksione për oficerët e policisë, prokurorët, gjyqtarët dhe organizata të shoqërisë civile. Instrumenti do të jetë ndërveprues dhe do të jetë i disponueshëm online për të gjithë palët e interesit nëpërmjet një faqe interneti të mbrojtur me fjalëkalim.

#### 4. Përmbajtja e trajnimeve

Secili trajnim fillonte me një seancë plenare për të prezantuar projektin SPIDERWEB dhe programin e trajnimit. Më pas, u morën mendimet e pjesëmarrësve për të kuptuar se cilat ishin pritshmëritë e tyre nga trajnimi. Kjo pasohet me një prezantim rreth bashkëpunimit dhe partneritetit, që synonte theksimin e rëndësisë së bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet palëve kyçe të interesit për të trajtuar me sukses krijimin mjedisor.

Trajnimet vijuan me seanca paralele lidhur me tema mbi Krimin në Sektorin e Mbetjeve dhe Mbrojtjen e Natyrës. U diskutuan raste studimore dhe u prezantuan mjetet që mbështetin autoritetet në ekzekutimin e detyrave të tyre. Seancat paralele ishin shumë ndërvepruese dhe pjesëmarrësit u sfiduan të kontribuonin në diskutime me pikëpamjet dhe përvojat e tyre. Ky format rezultoi mjaft i efektshëm dhe çoi në të nxënit dhe të kuptuarit dypalësh.

Çdo trajnim përfundoi me një seancë vlerësimi dhe një diskutim i hollësishëm mbi nevojat e ardhshme dhe në aplikimin e mësimave të nxjerra nga trajnimi. Secili pjesëmarrës mori një certifikatë si një provë e frekuentimit dhe pjesëmarrjes.

#### 5. Trajnimet dhe pjesëmarrja

Këto trajnime u realizuan gjatë periudhës nga muaji maj deri në nëntor 2019.

Gjithsej u trajnuan 162 pjesëmarrës (shihni tabelën), duke ruajtur një ekuilibër midis palëve kyçe të interesit që janë pjesë e zinxhirit të autoriteteve të përputhshmërisë dhe zbatimit në luftën ndaj krimit mjedisor. Kategoria 'tjetër' përfshinte ndër të tjerë, OJF, politikëbërës, drejtues dhe avokatë populli.

Tabela 1.

	Maqedonia e Veriut	Shqipëria	Kosova*	Serbia	Bosnjë-Hercegovina	Mali i Zi	
<b>Data e trajnimit</b>	7 – 9 Maj	14 – 16 Maj	5 – 7 Qershor	10 – 12 Shtator	24 – 26 Shtator	5 – 7 Nëntor	<b>Gjithsej:</b>
<b>Inspektorë</b>	12	9	11	12	7	3	<b>54</b>
<b>Autoritetet e lëshimit të lejeve</b>	0	0	0	1	0	3	<b>4</b>
<b>Oficerë policë</b>	4	2	1	2	18	2	<b>29</b>
<b>Oficerë dogane</b>	2	0	0	2	6	0	<b>10</b>
<b>Prokurorë</b>	1	2	2	8	1	3	<b>17</b>
<b>Gjyqtarë</b>	3	0	2	0	1	5	<b>11</b>
<b>OJF etj.</b>	8	9	8	5	3	4	<b>37</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>30</b>	<b>22</b>	<b>24</b>	<b>30</b>	<b>36</b>	<b>20</b>	<b>162</b>

## 6. Vlerësimi

Çdo seancë trajnimi i vlerësua në bazë të plotësimit të formularëve të vlerësimit. Formulari ishte hartuar në mënyrë të tillë që, duke u bazuar në 16 pyetje lidhur me cilësinë e përmbajtjes së trajnimit, trajnuesve, zbatueshmërinë e njohurive të ofruara, lidhja me punën, akomodimi etj, mund të jepej një pike nga shkalla 1-10. Pikët mesatare për ekonomitë e Ballkanit Perëndimor paraqiten në Tabelën 2 dhe variojnë nga 8,69 në 9,56. Pika mesatare totale është 9,10, e cila tregon se trajnimet u pritën dhe u vlerësuan mjaft mirë. Përveç dhënies së pikëve për trajnimet, pjesëmarrësit patën mundësinë të ofronin përshtypjet e përgjithshme rreth trajnimit, vërejtjet, sugjerimet dhe këshillat, si dhe të shprehnin nëse nevojiteshin aktivitete pasuese. Nëpërmjet një diskutimi të hapur në fund të çdo trajnimi, pjesëmarrësit ofruan komente të vlefshme të cilat ishin shumë të dobishme për detajimin e punës në vazhdim. Shumica e rezultateve të vlerësimit janë pasqyruar në përfundimet dhe rekomandimet e projektit (shihni kapitullin 9).

Tabela 2.

	Maqedonia e Veriut	Shqipëria	Kosova*	Serbia	Bosnjë-Hercegovina	Mali i Zi	<b>Pikët mesatare totale</b>
<b>Pikët mesatare për trajnimin</b>	9,16	9,56	8,69	8,80	8,88	9,31	<b>9,10</b>

## 7. Paketë trajnimi online

Materialet e përdorura gjatë trajnimit, duke përfshirë slide-t, studimet e rastit dhe referencat për legjislacionin dhe instrumentet, janë mbledhur dhe ofruar përmes një platforme online: Portali për ligjzbatuesit mjedisorë<sup>3</sup> (PREVENT). Janë krijuar dy paketa: një mbi krimin ndaj botës së egër dhe një mbi krimet në sektorin e mbetjeve. Këto paketa synojnë t'u sigurojnë agjencive ligjzbatuese, autoriteteve doganore dhe portuale, inspektorëve mjedisorë, prokurorëve dhe gjyqtarëve informacionet kryesore mbi krimet ndaj botës së egër dhe krimet në sektorin e mbetjeve, mbetjet ndërkombëtare, si dhe mbi traktatet dhe rregulloren e mbrojtjes së botës së egër. Paketat janë një përmbledhje e informacioneve dhe praktikave të mira nga manualet dhe raportet përkatëse, legjislacioni, studimi i rasteve dhe instrumentet e mbledhura dhe të krijuara për të mbështetur të gjithë zinxhirin e autoriteteve të zbatimit që lufton krimin ndërkufitar ndaj botës së egër me kosto më efikase.

Portali ofrohet vetëm për rregullatorët, praktikantët dhe zyrtarët përgjegjës për aplikimin dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor. Aksesit mund të kërkohet përmes faqes së internetit: [www.impel-prevent.eu](http://www.impel-prevent.eu)

## 8. Konferenca përfundimtare e projektit SPIDERWEB

Konferenca përfundimtare e projektit SPIDERWEB u mbajt më 12 dhe 13 nëntor 2019 në Zagreb. Konferenca u ofroi 45 pjesëmarrësve mundësinë për t'u mbledhur së bashku për të diskutuar zinxhirin e autoriteteve të përputhshmërisë në tërësi. U zhvilluan seanca specifike dhe workshop-e mbi temat kyçe, për të vijuar me një diskutim paneli, në të cilin përfaqësuesit e ekonomive të Ballkanit Perëndimor mbajtën deklarata dhe kontribuuan në diskutimin rreth temave dhe vlerës së përjetuar të projektit, pikëpamjet e tyre mbi mënyrën e aplikimit të rezultateve, si dhe një parashikim mbi aktivitetet dhe nevojat për mbështetje në të ardhmen. Përpos kësaj, u organizua një diskutim plenar mbi aplikimin praktik të rezultateve të projektit SPIDERWEB dhe mbështetjes së nevojshme apo të pritshme nga organizata mbështetëse, siç është IMPEL. Konferenca u mbyll me prezantimin e përfundimeve përfundimtare dhe me rekomandime për projektin.

## 9. Përfundime dhe rekomandime

### 9.1. Përfundime

Rezultatet e projektit konfirmuan se:

- Mirëpresin mundësinë e pjesëmarrjes në trajnime, të cilat ofrojnë ndihmë praktike dhe zgjidhje për të gjithë pjesëmarrësit, si dhe ndihmojnë individët me më pak përvojë që të mësojnë nga praktikantët me më shumë përvojë.

---

<sup>3</sup>PREVENT mundësohet përmes: [www.impel-prevent.eu](http://www.impel-prevent.eu)

- Trajnimet dhe konferencat pasqyrojnë nevojën e tyre për rritjen e ndërgjegjësimit dhe aftësive të të gjithë aktorëve të zinxhirit të autoriteteve të përputhshmërisë dhe zbatimit për të trajtuar në mënyrë efikase krimet e mjedisit; në veçanti krimet në sektorin e mbetjeve dhe mbrojtjen e botës së egër.
- Pjesëmarrësit i pritën mjaft mirë trajnimet. Mes pjesëmarrësve mbizotëroi një frymë pranimi mbi rëndësinë thelbësore të bashkëpunimit ndërmjet aktorëve brenda vendit dhe jashtë për një luftë të suksesshme kundër këtyre krimeve. Trajnimet lehtësuan takimin mes autoriteteve.
- Lufta efikase e krimit mjedisor kërkon një qasje gjithëpërfshirëse dhe multidisiplinare në të gjitha nivelet, si dhe përfshirjen e të gjitha politikave, instrumenteve dhe autoriteteve përkatëse.
- Për trajtimin e krimeve mjedisore, nevojitet përfshirja e specialistëve përmes një qasjeje multidisiplinare, siç është ekspertiza mjedisore, financiare, mjekoligjore dhe ajo e krimit kibernetik.
- Ata e dinë se të gjitha lidhjet e zinxhirit të autoritetit të përputhshmërisë dhe zbatimit janë në varësi të cilësisë dhe ekspertizës së lidhjeve të tjera. Si rrjedhojë, kontrolli i përputhshmërisë dhe ndjekja penale e krimit mjedisor është po aq i fortë sa lidhja më e dobët e zinxhirit.
- Bashkëpunimi me vendet fqinje dhe mbështetja e organizatave ndërkombëtare duhet të zhvillohet më tej, gjë e cila mund të arrihet përmes aplikimit të aktiviteteve të përbashkëta.
- Mbledhja dhe shpërndarja e informacionit nga dhe midis partnerëve kryesorë, kërkon një qëndrim aktiv. Shërbimet e inteligjencës duhet të mblidhen në mënyrë efikase dhe të efektshme, si dhe të analizohet dhe të përdoret në mënyrë të kujdesshme dhe konsistente në procesin e ligjzbatimit dhe procedimit penal.
- Instrumentet<sup>4</sup> e zhvilluara nga IMPEL përbëjnë burime të dobishme informacioni për përfituesit e projektit. Në këto instrumente përfshihen udhëzimet për inspektimin e landfillëve, manualin e vendit të mbetjeve dhe udhëzuesin hap pas hapi për inspektimet e dërgesave të mbetjeve. Gjithashtu, IMPEL-ESIX<sup>5</sup> është njohur si një instrument i dobishëm në kohë reale për shkëmbimin e informacioneve dhe bashkëpunimin çështjet mbi ruajtjen e natyrës midis zyrtarëve ligjzbatues, si dhe midis autoriteteve kombëtare (ndërkombëtare) dhe organizatave rajonale të palëve të interesit.

## 9.2. Rekomandime

Projekti rekomandon se:

### 9.2.1. Të përgjithshme

- Organizatat që promovojnë përforcimin e luftës ndaj krimeve mjedisore në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, nxiten të vazhdojnë të mbështesin rajonin përmes organizimit dhe financimit të aktiviteteve praktike, të tilla si rritjen e kapaciteteve dhe projekteve të përbashkëta. Aktualisht, asnjë program tjetër i BE-së apo rajonal nuk vepron në këtë fushë. Duke qenë një situatë “Jep dhe Merr”, organizatat e ekonomive të Ballkanit Perëndimor do të ofrojnë burimin e kohës së ekspertizës për të menaxhuar dhe drejtuar aktivitete të tilla.
- Duke u bazuar në përvojat e projektit SPIDERWEB, duhet të merret në konsideratë vazhdimësia e projektit ose ndërmarrja e një projekti të ri me fokus në trajnimin praktik dhe të specializuar, duke përfshirë shenjëstrimin e kategorive specifike të specialistëve, me qëllim përmirësimin e zbulimit të rasteve të krimit mjedisor dhe shkëmbimin aktiv të praktikave të mira, të dyja në nivel rajonal dhe kombëtar. Qasja ndaj kësaj mund të jetë horizontale (duke përfshirë të gjithë aktorët në zinxhirin e autoriteteve të përputhshmërisë dhe zbatimit) dhe/ose vertikale (duke u përqendruar në një autoritet specifik, p.sh. dogana, gjyqësori ose inspektorati mjedisor).

<sup>4</sup>Aksesi në instrumentet e IMPEL përmes: <https://www.impel.eu/tools/>

<sup>5</sup>Aksesi në instrumentet e IMPEL ESIX përmes: <https://www.impel-esix.eu/>

- Krijimi i partneriteteve me shoqërinë civile dhe bashkëpunim i rregullt dhe shkëmbim informacioni me OJF-të kombëtare që operojnë në fushën e mjedisit, si dhe të diskutohen masat e duhura për të përmirësuar rolin e këtij të fundit në procedimet penale.
- Zhvillimi i programeve parandaluese dhe fushatave të ndërgjegjësimit kundër krimeve mjedisore, duke synuar sektorin publik dhe/ose grupet specifike të rrezikut, sjelljet e rrezikut, si dhe subjekte të reja mjedisore të identifikuara si me rrezik të lartë.
- Hartimi i një kurrikule të përparuar trajnimi për grupet e ndryshme të synuara, e cila duhet të përfshihet në programet e trajnimit dhe të drejtohet nga akademitë e certifikuar të trajnimit.
- Rishikimi dhe përditësimi i 'Procedurave aktuale standarde të veprimit' dhe përfshirja e tyre në instrumentin online.
- Shpërndarja aktive e informacionit të kontaktit të të gjithë pjesëmarrësve të projektit.

### 9.2.2. Niveli kombëtar

Përfituesit pjesëmarrës dhe autoritetet përkatëse të përfshira në projekt, ftohen në marrin në konsideratë sugjerimet dhe rekomandimet e mëposhtme:

- Krijimi i një platforme të strukturuar midis agjencive ose rrjeti kombëtar për koordinimin dhe bashkëpunimin ndërinstucional në përputhje me zbatimin e legjisllacionit mjedisor, në të cilin të marrin pjesë përfaqësuesit e të gjitha shërbimeve dhe autoriteteve ligjzbatuese, si dhe gjyqësori (prokuroritë dhe gjykatat) i përfshirë. Kjo strukturë duhet të formalizohet përmes protokolleve ose Memorandumeve të Mirëkuptimit.
- Zhvillimi i një platforme në nivel kombëtar me pjesëmarrjen e të gjitha palëve kyçe të interesit, si dhe krijimi dhe miratimi i një vizioni, strategjie dhe politike mbi përputhshmërinë dhe zbatimin mjedisor, për t'u përfshirë në një Plan kombëtar (sipas vendit) me plane pune të autoriteteve individuale.
- Përfshirja e prioritetëve, qasjeve dhe përshkrimi i qartë i roleve dhe përgjegjësi të të gjitha autoriteteve të përfshirë në Planin kombëtar.
- Rivlerësimi në nivel kombëtar i ekuilibrit midis qasjes administrative dhe penale ndaj krimit mjedisor, me qëllim që ligji penal të kryejë plotësisht funksionin e tij ndëshkues dhe kufizues.
- Rishikimi i legjisllacionit kombëtar në aspektin e diferencimit të krimeve të vogla dhe të mëdha dhe shkeljeve administrative të legjisllacionit mjedisor, duke synuar zhvillimin e një politike për përdorimin më efikas të sanksioneve në shkelje të legjisllacionit mjedisor.
- Duke pasur parasysh natyrën dhe shkallën e Planit Kombëtar për përputhshmërinë dhe zbatimin e legjisllacionit mjedisor, nevojitet monitorimi, vlerësimi dhe raportimi i duhur mbi efikasitetin.
- Caktimi i një pike kontakti për të koordinuar bashkëpunimin për përputhshmërinë dhe aktivitetet e aplikimit me autoritete të tjera. Kjo pikë duhet të jetë e përfshirë në rrjetin jokombëtar dhe rajonal (Ballkani Perëndimor) i pikave të kontaktit.
- Promovimi i shkëmbimit aktiv të informacionit midis autoriteteve kompetente mjedisore (inspektorët e mjedisit), shërbimet policore, shërbimet ndaj klientit, si dhe prokuroritë dhe gjykatat. Pikat e kontaktit të autoriteteve duhet të luajnë një rol kyç në menaxhimin e informacionit.
- Për të mbështetur punën e platformës dhe autoriteteve përkatëse, duhet të merret në konsideratë zhvillimi i një sistemi të integruar të informacionit, i cili përmban të dhënat e mbledhura nga të gjitha autoritetet pjesëmarrëse. Përmes analizës së të dhënave dhe statistikave të mbledhura, do të mund të kuptohen fenomenet (kriminale), të cilat do të promovojnë trajtimin e krimit mjedisor në mënyrë gjithëpërfshirëse, sistematike, të besueshme dhe efikase.
- Zhvillimi i specializimit në krimin mjedisor në polici dhe gjyqësor, siç janë prokurorë të specializuar përgjegjës për çështjet mjedisore dhe një rrjet kombëtar ekspertizash për magjistrat mjedisorë.

- Ngritja e një njësie qendrore mjedisore në polici dhe/ose inspektoratin mjedisor në nivel kombëtar. Në këtë mënyrë, do të shërbente si platformë për të mbështetur dhe promovuar qasjen multidisiplinare ndaj krimeve mjedisore dhe si partner aktiv në nivel ndërkombëtar (Interpol, Europol dhe BE).

### 9.2.3. Bashkëpunimi ndërkufitar

Duke qenë se krimi mjedisor i tejkalon kufijtë e shteteve, rekomandimet e mëposhtme përfshijnë punën ndërkufitare:

- Krijimi i rrjetit rajonal në Ballkanin Perëndimor për autoritetet e përfshira në trajtimin e krimit mjedisor për ndarjen e përvojave dhe praktikave të mira dhe për koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta përmes takimeve të rregullta.
- Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor duhet të përpiqen të harmonizojnë dhe të sanksionojnë shkeljet e legjislacionit mjedisor për të kapërcyer situatën aktuale të çekuilibruar. Harmonizimi do të sjellë kushte të barabarta.
- Marrja në konsideratë e aftësisë së pamjaftueshme të ekspertizës dhe ekspertëve specifikë për të krijuar një grup ekspertësh ndërkombëtarë, të cilët mund të punojnë në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor sipas kërkesës dhe në raste specifike kur ekspertiza e tyre është e nevojshme.
- Bashkëpunimi dhe sinergjia midis laboratorëve dhe instituteve shkencore brenda dhe midis ekonomive të Ballkanit Perëndimor duhet të nxitet dhe të eksplorohej. Nevojitet krijimi i një rrjeti kontaktesh dhe bashkëpunimi duhet të formalizohet përmes Memorandumit të të Kuptuarit.
- Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor duhet të sjellin frymë bashkëpunimi ndërkufitar midis autoriteteve përgjegjëse, me qëllim shkëmbimin aktiv të informacioneve për të trajtuar krimet mjedisore (ndërkombëtare) në mënyrë efikase.
- bashkëpunimi ndërkufitar duhet të promovohet dhe të nxitet përmes kryerjes së aktiviteteve të përbashkëta. Kjo gjë mund të lehtësohet përmes një programi shkëmbimi për përfaqësuesit e autoriteteve të ndryshme.
- Promovimi i bashkëpunimit për të shpëtuar bimët dhe kafshët e kapura. Duhet të konsiderohet krijimi i një stacioni rajonal shpëtimi dhe/ose një pike koordinimi për shpëtimin e florës dhe faunës së gjallë në kopshte zoologjike apo institucione të specializuara në këto specie.

*Projekti SPIDERWEB preku sfidat e shumta me të cilat përballlet Ballkani Perëndimor kur bëhet fjalë për frenimin e krimeve ndaj botës së egër dhe krimeve në sektorin e mbetjeve. Ndërgjegjësimi i vazhdueshëm dhe kapaciteti për të lidhur organizatat që luajnë rol në parandalimin, detektimin dhe ndjekjen penale të krimeve mjedisore, përbën çelësin e suksesit. IMPEL mund të luajë rol lehtësues në hapat e ardhshëm.*